



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.43/2016

Prishtinë, 23 nëntor 2016,

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi.

Munguan: Nenad Rashiq, Mytaher Haskuka dhe Kujtim Paçaku.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Ferat Shala, u.d. ministër - MMPH, Arben Çitaku - Sekretar i Përgjithshëm-MMPH, Naser Bajraktari-MMPH-drejtor, Agron Haxhiu, KEDS - Mitrovicë, Imer Salihi-D.SH.P, Skenderaj, Sokol Hoxha-D.SH.P, Skenderaj, Flora Kryeziu-UNICEF, Arbëresha Hakaj-AAK Asistente, Agnesa Haxhiu-KDI, Alije Avdyli-AVONET, Kenan Gashi-AVONET, Vlora Morina -AVONET, Kaltrina Zymeri-Ekonomia Online, Fëllënëza Knushaj-CSGD.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Raportimi në Komision:

- a) Ministri, z. Ferat Shala, lidhur me kërkesën e banorëve të fshatit Vranishtë, Komuna e Dragashit, për ndërtimin e hidrocentralit në lumin e këtij fshati si dhe me çështjet që kanë të bëjnë me eksproprijimin e pronave të atyre banorëve.
- b) Përfaqësuesi/t e KEDS, Distrikti Mitrovicë, lidhur me ankesën e z. Sabit Hoxha, fshati

Rezallë, Komuna e Skenderajt, për instalimin e tensionit të lartë mbi objektin e pikës së shitjes së karburanteve.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës,

3. Të ndryshme.

1. Raportimi në Komision;

a) Ministri Ferat Shala, lidhur me kërkesën e banorëve të fshatit Vranishtë, Komuna e Dragashit, për ndërtimin e hidrocentralit në lumin e këtij fshati si dhe me çështjet që kanë të bëjnë me eksproprijimin e pronave të atyre banorëve

Lirije Kajtazi, kryetare, tha se ne kemi pranuar kërkesën e banorëve të fshatit Vranishtë, të Komunës së Dragashit, për ndërtimin e hidrocentralit në lumin e këtij fshati si dhe me çështjet që kanë të bëjnë me eksproprijimin e pronave të atyre banorëve, por sot ju kemi ftuar juve që të kemi këtë komunikim të drejtpërdrejtë, për t'i parë shqetësimet që janë paraqitur nga banorët.

Ferat Shala, u.d së ministrit në MMPH, tha se do të mundohemi që bashkërisht të japim përgjigje në ato shqetësime që janë ngritur. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor menaxhon me resurset natyrore dhe mbështetet në strategjinë zhvillimore për sektorin energjetik, të miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera. Ne kemi zbatuar të gjithë rregullativën ligjore për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve mjedisore sa u përket ndërtimeve të kapaciteteve hidroenergjetike në disa zona të Kosovës dhe ato gjithnjë të parapara në strategjinë për zhvillimin e këtij sektori. Legjislacioni e ka krijuar këtë mundësi, e gjithë ajo që ka ndodhur viteve të fundit është në harmoni me ligjin.

Ne në ministri kemi pranuar përfaqësuesit e qytetarëve, kemi mbajtur dëgjime me qytetarë, kemi bashkëbiseduar me nivel ekspertësh dhe mendoj se i kemi përmbush parametrat të cilët kërkohen të përmbushën me legjislacion.

Lirije Kajtazi tha se ankesa më shumë ka të bëjë me procedura. Thuhet se nuk ka pasur debat publik, ku nuk është dhënë pëlqimi dhe thuhet se është pjesë e Parkut Nacional. A lejohet që të ndërhyhet me projekte të tilla dhe a jemi korrekt në këto çështje?

Ferat Shala: E kam thënë edhe në komisionet tjera se me këtë legjislacion që e kemi, me planin legjislativ t'i ndryshojmë ligjet për parqet, kemi dy parqe nacionale të themeluara me ligje të veçanta dhe konsideroj se këto ligje duhet t'i ndryshojmë, por konsideroj se ne jemi brenda asaj se çka e thotë legjislacioni në fuqi.

Arben Çitaku, sekretar i Ministrisë së MPH, tha se këtu janë të përfshirë shumë aktorë, Komuna, Ministria e Pushtetit Lokal që mbikëqyrë veprimet e Komunës, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, dhe të gjitha këto e kanë një procedurë për të ardhur deri te përcjellja e këtyre kapaciteteve.

Ne si shtet jemi të obliguar që deri në vitin 2023 të shtojmë kapacitetin e energjisë së ripërtritëshme me mbi 20%.

Në rastin konkret, te qytetarët janë disa parcela të cilat preken, qoftë nga ndërtimi i rrugës së qasjes, qoftë nga servituti i gypit i cili do të kalojë nëpër pronat që kryesisht janë disa livadhe afër bregut të lumit, po vet bregu i lumit dhe lumi është pronë publike, e cila menaxhohet nga ministria.

Dëgjim publik për këtë çështje ka pasur dhe janë respektuar të gjitha procedurat. Kuvendi Komunal ka marrë vendimin për shpronësimin e këtyre parcelave, ku do të ndërtohen këto kapacitete, dhe pas këtyre proceduarve, është dhënë pëlqimi mjedisor nga ana e ministrisë sonë, dhe pas kësaj kompania aplikon dhe sipas procedurave mbahet edhe një debat publik vetëm për pjesën e mjedisit. Për të gjitha këto ekzistojnë dëshmitë, hapi i radhës është lëshimi i lejes ujore. Ligji i Parkut Nacional është i ndarë në tri zona sa i përket shfrytëzimit, të gjitha projektet që janë pjesë e zonës së tretë i lejohet aktiviteti në kushte të caktuara, ndërsa në zonën e parë dhe të dytë janë të ndaluara, ndërsa për këto projekte në fjalë edhe pse bëhet fjalë për Parkun Nacional, janë në zonën e tretë.

Teuta Haxhiu tha se nga ajo që u tha, pritet të mbahet një takim për të kuptuar ata banorë se cilat janë benifitet, dhe na tregoni se cilat janë ato benifite që përfitojnë këta banorë me ndërtimin e këtij hidrocentrali. A rrezikohet me këtë sektori i bujqësisë?

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se disa dilemat që i patëm veçse u sqaruan nga të ftuarit, në kërkesën e banorëve të Vranishtës, ku thuhet se Kuvendi Komunal nuk e ka shpjeguar në detaje qëllimin e debatit publik.

Sa i përket çështjes së shpronësimit, besoj se nuk do të ju mbeteni borxh atyre banorëve. Ajo u interesua të dijë se a do të rrezikohet tharja e lumit dhe pyeti se a ka njohuri se sa e përdorin ata banorë ujin për tokat bujqësore të tyre dhe pas kësaj, a do të kenë mundësi ta shfrytëzojnë ende.

Salihe Mustafa: Me sa kuptova, ju si ministri jeni duke u marrë me problemet e këtyre banorëve. Këtu u cek se këto gjëra rregullohen në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, Ministrinë e Pushtetit Lokal, Ministrinë e juaj dhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Ajo u interesua të dijë se a janë të rregulluara mirë në ligj dhe a ceket se cili është institucioni që e merr nismën dhe ka bashkëpunim apo ka probleme në këtë drejtim.

Shukrije Bytyçi: Banorët i kanë shpreh shqetësimet e veta në këtë kërkesë. Më intereson të dijë se edhe sa kohë do të vazhdohet me këtë, që nga vendimet të ketë interes individit e jo qytetarët. A keni bërë studim ju në ndërtimin e ekosistemit, kur dihet se ajo pjesë atje jeton nga bujqësia.

Etem Arifi: Besoj se të gjitha veprimet që është dashur të ndërmerren nga ju si ministri i keni ndërmarrë dhe puna është kryer. Nuk dyshoj në atë se a ka pasur debat publik, sa i përket përfitimit, po besoj se ata banorë do të përfitojnë, sepse ky është projekt nacional, por është bërë praktikë që qytetarët të ankohen.

Dëgjimi publik është mbajtur, ndërsa, pse qytetarët nuk janë përgjigjur në numër më të madh, është çështje e tyre.

Ferat Shala: Ne jemi para një dileme: a i duhet Kosovës zhvillim ekonomik dhe a duhet t'i shfrytëzojmë resurset, dhe nëse themi po, atëherë duhet të pajtohemi për gjetjen e metodave të shfrytëzimit.

Legjislacioni është i qartë edhe për shpronësim edhe për servitut, por gjithnjë ka vend për përmirësime.

Në rastin konkret, shkalla e parë është komuna dhe qytetarët, ministria që ai drejton është institucion i shkallës së dytë, dhe të gjithë jemi të obliguar ta zbatojmë legjislacionin në fuqi.

Në fund, kryetarja propozoi që për shkak të interesit të përgjithshëm dhe kujdesit të Komisionit që ajo drejton, lidhur me këtë çështje, anëtarja e Komisionit znj. Shukrije Bytyçi, të merr pjesë në aktivitetet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, sa i përket çështjeve që ndërlidhen me ndërtimin e hidrocentralit në lumin e fshatit Vranishtë, Komuna e Dragashit.

Anëtarët e Komisionit përkrahën propozimin e kryetares, ndërsa deputetja Shukrije Bytyçi, shfaqti gatishmërinë e saj për të kontribuar në mbarëvajtjen e këtij procesi.

1. Raportimi në Komision:

b) Përfaqësuesi/t e KEDS, Distrikti Mitrovicë, lidhur me ankesën e z. Sabit Hoxha, fshati Rezallë, Komuna e Skenderajt, për instalimin e tensionit të lartë mbi objektin e pikës së shitjes së karburanteve

Lirije Kajtazi, kryetare, tha se në radhë kemi ankesën e z. Sabit Hoxha nga fshati Rezallë, Komuna e Skenderajt, për instalimin e tensionit të lartë mbi objektin e pikës së shitjes së karburanteve, ku pala konsideron se është bërë një shkelje, dhe do të mundohemi që të japim kontributin tonë në zgjidhjen e këtij problemi.

Imer Salihi, inspektor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, KK Skenderaj, tha se si inspektion kemi marrë masa dhe e kemi bërë kontrollimin e objektit.

Në bazë të një udhëzimi administrativ kemi ndërmarrë masa, është ndëshkuar pronari i biznesit për shkak se nuk posedon licencë për shitjen e derivateve me shumicë dhe pakicë, e cila është kompetencë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ministria nuk jep licencë për shkak se nuk i plotëson kushtet, për të ardhur deri te licenca kërkohet një pëlqim nga Ministria e Punëve të Brendshme, atë nuk e jep MPB-ja për shkak të tensionit të lartë që e ka mbi rezervuar. Para 5 a 6 viteve e ka pasur licencën, dhe asaj licence i ka skaduar afati. Për marrjen e licencës janë të parapara 12 dokumente që duhet poseduar .

Ai më pas theksoi se ankuesi do të duhej që fillimisht ti drejtohet KEDS-it, për heqjen e tensionit të lartë, apo ndoshta edhe gjykatës.

Lirije Kajtazi pyeti se a keni njohuri se pala i është drejtuar gjykatës lidhur me këtë lëndë, nëse lënda është në gjykatë Komisioni nuk përzihet në kompetencat e organit të drejtësisë.

Agron Haxhiu, drejtor i Distriktit të KEDS-it në Mitrovicë, tha se shtylla është vendosur kur objekti në fjalë nuk ka zhvilluar veprimtarinë e biznesit. Biznesi në fjalë më vonë ka aplikuar për licencë, çështja se si e ka marrë licencën është çështje tjetër, që unë nuk e di.

Ne duhet ta zgjidhim këtë problem dhe pas tre muajve ta zhvendosim atë shtyllë, por nuk besoj që as inspektorati, as Kuvendi Komunal dhe asnjë ministri mund të lejojë për ta zhvilluar atë veprimtari, ku rezervuari i karburanteve është në oborr.

Ky persona ka bërë padi në gjykatë dhe nuk ka lënë institucion pa e alarmuar për këtë çështje, edhe pse i ka skaduar licenca.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se biznesi ka fillua veprimtarinë pa u vendos shtylla elektrike, objekti ka marrë leje ndërtimi në vitin 2002, licenca ju ka dhënë pas disa viteve.

Ne ju kemi ftuar këtu të diskutojmë për padrejtësitë që po i bëhen personit Sabit Hoxha, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka dhënë përgjegje në vitin 2014, që KEDS-i, ta zhvendosë atë shtyllë dhe ju ka dhënë afat 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Unë mendoj se duhet të zbatohet vendimi i gjykatës, ndërsa konstatimet e ankuesit, se KEDS-i ia ka pamundësuar ekzistencën për jetë, për mua flasim shumë këto konstatime.

Agron Haxhiu tha se neve nuk na ka ardhur asnjë vendim nga gjykata dhe nuk jemi në dijeni për këtë.

Shukrije Bytyçi: Ankesa e Sabit Hoxhës, është se rrezikohet jeta e familjes së tij nga shtylla elektrike. KEDS-i mos të thirret në atë se a ka ai pëlqim apo jo. Ushtrimi i veprimtarisë është çështje tjetër, ndërsa rreziku i jetës nga tensioni i lartë është një çështje tjetër.

KEDS-i duhet të evitohet shtyllën e tensionit, ndërsa sa i përket çështje së plotësimit të kushteve të funksionimit të pikës së shitjes së karburanteve, ne nuk jemi kompetentë për të vlerësuar këtë. Kjo çështje është punë e instancave të tjera.

Lirije Kajtazi: Meqë lënda qenka çështje e gjykatës, atëherë të gjitha instancat përgjegjëse për këtë çështje, duhet t'i kryejnë detyrat e veta në pajtim me vendimin e gjykatës.

Salihe Mustafa: Propozoj që si Komision t'i rekomandojmë KEDS-it, që të zbatohet vendimin e gjykatës, sepse këtu po flitet për afate, por deri sa ne po diskutojmë këtu rreziku ekziston gjithnjë dhe pastaj faji nuk është i askujt.

Lirije Kajtazi konstatoi që Komisioni ti rekomandojë KEDS-it, Distrikti Mitrovicë, zbatimin e vendimit të gjykatës, lidhur me këtë rast.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Lirije Kajtazi, kryetare, tha se për shqyrtimin e këtij Projektligji, po e formojmë një grup punues, i cili do të punojë për së afërmi në këtë Projektligj, por edhe anëtarët e tjerë të Komisionit mund të bashkohen dhe të japin kontributin e tyre.

Komisioni njëzëri vendosi që të formojë grupin punues në këtë përbërje:

Mexhide Mjaku-Topalli, kryesuese, Teuta Haxhiu dhe Etem Arifi, anëtarë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Lirije KAJTAZI